




Ergys Kace i ka bere thirrje Adnand Januzaj per te mos e refuzuar Shqiperine. Mesfushori korcar qe refuzoi Greqine per ngjyrat kuqezi ne faqen e tij ne facebook i ka bere thirrje Januzajt per te pranuar oferten e FSHF-se. “Adnan, mos e hidh poshte gjakun tend. Vepro si une dhe te premtoj se nuk do te zhgenjehesh. Nuk ka me mire se te luash per atdheun, te luash per territorin tend dhe te duartrokitesh nga tifoze qe te duan ty te miren. Adnan eja tek ne”, i ka thene Kace mesfushuorit qe luan ne Angli per Manchester United.